



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 21.12.2016, e cila filloi në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Agim Gashi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hetem Kupina (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Berat Lahu (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Shaip Shabani (PDK), Laura Zherka (PDK), Egzona Podvorica (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Nenad Miladinoviç, përfaqësues i subjektit politik (GIS), Cuneyd Ustaibo (KDTP).

**Munguan:** Flamur Shala (LDK), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF) dhe Abit Kastrati.

**Të pranishëm** ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.  
Ai e hapi diskutimin rreth rendit të ditës.

**Sylejman Pireva** ngriti shqetësim lidhur me cenimin e tij si anëtar i Kuvendit, që i është bërë nga kolegu Flamur Shala në seancën e fundit të Kuvendit, duke thënë se do të dëshiroja që një situatë e tillë të jetë e fundit dhe të mos përsëriten më gjëra të tilla.

**Shefki Gashi** ngriti çështjen e furnizimit me ujë të më se 12 fshatrave të komunës së Prishtinës, të cilat janë në gjendje jashtëzakonisht të rëndë për furnizim me ujë, siç janë fshatrat: Grashticë e Ulët, Grashticë e Epërme, Mramor, Suteskë, Busi, Slivovë, Mukatë, Dragoc, një vij që shkon deri te kufiri me Artanën. Uji në atë pjesë është i papërdorshëm, shkollat nuk kanë fare ujë, ku higjiena mbetet për të dëshiruar. Duke pasur parasysh këtë gjendje, kërkoj që ta bëjmë projektin si komunë, duke kërkuar donacione edhe prej Qeverisë, prej ministrive etj., në mënyrë që t'ua bëjmë një zgjidhje atyre qytetarëve.

**Fadil Gashi** e përkrahu idenë e Shefkiut, duke thënë se ujësjellësi është më se i nevojshme për ato fshatra.

**Mirlinda Sopi**, ceku se ne si GP, me marrëveshje, po e propozojmë që sot të hyjë në rend të ditës për diskutim pika "Plani rregullues për lagjen "Kodrina". Besoj që është në interes të qytetit që kjo pikë të trajtohet dhe të kalojë.

**Kryesuesi** lidhur me këtë pikë, tha se kjo është pikë e ndjeshme dhe materialin nuk e kemi. Nuk jemi kundër, por meqë materialin nuk e kemi, propozoj që ta lëmë për seancën tjetër.

**Qëndron Kastrati**, në emër të GP-së, e përkrahu propozimin e Mirlindës, që kjo pikë të jetë në rend të ditës, dhe të jetë si pikë e parafundit e rendit të ditës, ndërsa pika e katërt "Caktimi i anëtarëve në komisionet komunale të aksionarëve", të jetë pika e fundit.

**Agim Gashi** theksoi se LDK-ja nuk është kundër debatit për këtë pike të rendit të ditës, mirëpo përderisa nuk janë dhënë sqarimet ligjore se a është në përputhje plotësisht me ligjin përkatës, ne do të jemi të rezervuar sa i përket votimit, por procesi le të ecën, ne nuk e pengojmë.

**Lirak Çelaj** tha se ne në parim nuk jemi kundër kësaj pike dhe pikave të tjera të urbanizmit për t'u trajtuar. Këtë e kemi shprehur vazhdimisht, madje edhe në seancën e kaluar shumica e grupit ka votuar për, sidoqoftë, në parim nëse jemi dakord të gjithë, edhe ne e mbështesim që të futet në rend të ditës për trajtim.

**Genc Bashota**, në emër të ekzekutivit dhe në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Pronës, propozoi që pika e gjashtë "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë/juridikë", të hiqet nga rendi i ditës, për arsye të një problemi që ka të bëjë me hipotekë, e që ende nuk është zgjidhur.

**Agim Gashi** propozoi që propozimplani për "Kodrinën" të qitet në votim, por para se të votohet, kërkoj nga Zyra ligjore që të japë një sqarim të mirëfilltë ligjor, se a është në rregull që të hyjë në rend dite çështja e "Kodrinës".

**Ardian Olluri**, theksoi se materiali është prezantuar në mbledhjen e kaluar, gjithashtu përfaqësuesi i drejtorisë ka qenë i pranishëm, i ka dhënë sqarimet dhe nëse lihet ashtu si është propozuar, atëherë le të jetë për diskutim si pikë e parafundit.

**Kryesuesi** konstatoi se për t'u futur kjo pikë në rend dite, ishin 23 (njëzet e tri) vota për, 9 (nëntë) vota kundër, (Abetare Fazliu, Besa Rafuna, Cuneyd Ustaibo, Egzona Podvorica, Halim Halimi, Hetem Kupina, Laura Zherka, Muhamet Nura, Shemsi Veseli) dhe 12 (dymbëdhjetë) abstenime (Agim Gashi, Brahim Mehmetaj, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Merita Surkishi, Naime Osmani, Rita Begolli, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Sokol Krasniqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Ajnishahe Azemi). Si rezultat i këtij votimi, "Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtimin publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20 të lagjes "Mati 1" ("Kodrina)", futet në rend dite për diskutim.

**Kryesuesi**, konstatoi se më 19 (nëntëmbëdhjetë) vota për, 18 (tetëmbëdhjetë) vota kundër, (Blerand Stavileci, Brahim Mehmetaj, Egzona Podvorica, Fadil Gashi, Fisnik Osmani, Halim Halimi, Hetem Kupina, Imer Rusinovci, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Muhamet Nura, Naime Osmani, Rita Begolli, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Sokol Krasniqi), 6 (gjashtë) abstenime ( Abetare Fazliu, Mirlinda Sopi, Remzi Pacolli, Sami Boroci, Sofije Bunjaku, Ajnishahe Azemi), Caktimi i një anëtarë në Komisionin komunal të aksionarëve në NLP "Hortikultura" SHA dhe NPK "Trafiku Urban" SHA Prishtinë, kalon si pikë e dhjetë e rendit të ditës.

**Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, u miratua ky**

## R E N D I D I T Ë S:

1. **Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit;**
2. **Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të përgjithshëm për vitin 2015;**
4. **Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal natyror "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur;**
5. **Propozimvendimi për themelimin e grupit punues të Kuvendit të Komunës për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017;**
6. **Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për Komitetin për Komunitete;**
7. **Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike;**
8. **Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar, gjatë vitit shkollor 2015/2016;**

9. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtimin publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19 dhe B 20 të lagjes “ Mati 1” (“Kodrina”);
10. Caktimi i një anëtari në Komisionin komunal të aksionarëve në NLP “Hortikultura” SHA dhe NPK “Trafiku Urban” SHA Prishtinë;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Betimi i anëtarëve të rinj të Kuvendit.**

**Hetem Kupina dhe Berat Lahu** e bënë betimin para anëtarëve të Kuvendit.

#### **Pika e dytë**

**Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës.**

**Muhedin Nushi**, drejtor i Drejtorisë së Administratës, tha se fillimisht është diskutuar me të gjithë kryetarët e bashkësive lokale, janë mbajtur dy takime me ta, janë marrë vërejtjet e tyre dhe janë shqyrtuar, pastaj është formuar komisioni. E kemi vendimin për formimin e komisionit gjithëpërfshirës, prej të gjithë anëtarëve të partive politike që marrin pjesë në Kuvendin e Komunës së Prishtinës. Janë mbajtur dy takime me anëtarët e pranishëm, ka pasur vërejtje, të cilat janë marrë parasysh gjatë hartimit të rregullores. Si rezultat i gjithë kësaj pune, sot ju prezantojmë një rregullore, e cila i përmbush kriteret dhe nevojat për një riorganizim të bashkësive lokale.

**Hetem Kupina** theksoi se kjo rregullore në përmbajtje ka përfshirë qëllimin, fushëveprimin, formimin e këshillave dhe kriteret e përzgjedhjes, ndërprerjen dhe pushimin e mandateve të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave, bartjen e aktiviteteve nga Komuna tek këshillat komunalë, si dhe rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokalë. Ligji për Qeverisjen Lokale e kundërshton nenin 5, pika 7, ku thotë “Kandidatët për pozita të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokalë, nuk mund të zgjidhen kandidatët të cilët janë të zgjedhur në poste politike”. Në këtë rregullore nuk është precizuar mirë pika 9 e këtij neni, ku thotë “Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit, apo lagjeve urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve”. Kandidati duhet të zgjidhet nga anëtarët e këshillit të Bashkësisë lokale, ai që fiton vota më shumë, ai duhet shkuar, jo nga qytetarët, sepse nëse e lëmë nga qytetarët, i japim mundësi manipulimit. Po ashtu, në këtë dokument janë bërë disa lëshime rreth emërtimit të rrugëve nëpër fshatra dhe në pjesët urbane të Prishtinës, si p.sh. ngastra kadastrore, gjegjësisht komuna kadastrore “Nëntë Jugoviqët” tash “Bardhoshi”, nuk është përfshirë fare në listë, kështu që kërkoj nga komisioni që ta ketë në konsideratë këtë vërejtje.

Faqe 4 nga 16

**Ylli Hoxha** bëri të ditur se ai, në emër të GP të LVV-së, kishte qenë i pranishëm edhe në punimet që janë bërë lidhur me këtë rregullore, përveç në pjesën e ndarjes territoriale, që është ndoshta pjesa më e rëndësishme e këtij propozimi, sepse ka pasur defekte të mëdha ndarja e bashkësive lokale në organizimin e qytetit. Është bërë një punë e mirë dhe është kontribut i jashtëzakonshëm i DEMOS-it që e ka zhvilluar një proces konsultativ, në të cilin janë trajtuar disa prej çështjeve. Pjesa e ndarjes territoriale në qytet është tejet e rëndësishme dhe konsideroj se duhet të shkojë në këtë formë.

Po ashtu, janë disa risi që janë propozuar në këtë rregullore. E para, që është për t'u përshëndetur, është se parashihet një prag minimal i pjesëmarrjes në mbledhjen për zgjedhjen e këshillit të bashkësisë lokale. Konsideroj se më i sigurt është qytetari sesa këshilli, dhe në çfarëdo forme përparësi do t'i jepja qytetarit me e zgjedhur kryetarin e bashkësisë lokale drejtpërdrejt, sesa një grupi të këshillit.

LVV-ja e mbështet këtë rregullore.

**Lirak Çelaj** tha se në parim e përkrahim dhe do të ishte mirë në të ardhmen të organizohet si proces zgjedhor, nëse duam të kemi përfaqësim të njëmendtë të lagjeve, e që është shumë e rëndësishme. Ne jemi të bindur që do të jetë një njeri që përfaqëson një subjekt politik, ose që do të jetë i sponsoruar nga një subjekt politik, sepse gara në të kaluarën, e besoj edhe tash, do të jetë kryesisht në mes të subjekteve politike.

Do të duhej të na prezantohet kjo ndarje territoriale përmes skicës, sepse në bazë të rrugëve është shumë vështirë të orientohemi dhe të dimë se si duken këto harta të bashkësive lokale.

**Mirlinda Sopi** u shpreh se edhe ne e kemi analizuar këtë rregullore dhe në parim, edhe në KPF kam thënë, do ta përkrahim, me vërejtjen e dhënë për pikën 7 të nenit 5, të ndryshohet ose të hiqet krejt ai nen. Meqenëse kemi të bëjmë me propozimrregullore që shkon në diskutim publik, me përmirësime dhe me vërejtje do të na kthehet edhe njëherë në Kuvend.

**Rita Begolli**, e përkrahu propozimrregulloren që të dërgohet në diskutim publik.

**Kimet Zeqa**, në emër të GP-së, e përkrahu dërgimin e propozimrregullores në diskutim publik.

**Abetare Fazliu** e përkrahu propozimrregulloren, por bëri vërejtje dhe kërkoi që të shikohet edhe një herë për rrugën në lagjen "Kodra e Diellit", që është rr. "Afrim Zhitia", është bartur tek lagja "Aktashi", ndërsa te lagja "Kodra e Diellit" duhet të ceket rruga "2 Nëntori", sepse ashtu ka qenë në listë. Pra, të shikohet edhe njëherë dhe të bëhet ky ndryshim.

**Cuneyd Ustaibo** e përkrahu propozimrregulloren.

**Nenad Milladinoviq** e përkrahu dërgimin e propozimrregullores në diskutim publik.

**Qëndron Kastrati** shprehu mendimin se përderisa kjo rregullore dërgohet në diskutim publik, atëherë mund t'i paraqes 3-4 çështje për t'i trajtuar. Çështja e parë, ka të bëjë me nenin 6, paragrafi 4, nënparagrafin 6, ku thuhet "Kur personi kryen vepër penale", mendoj se duhet të jetë "Kur personi dënohet për vepër penale me vendim të formës së prerë", sepse nëse e lëmë kështu si është, ka hapësirë për keqkuptim. Kush e konstaton a është kryer vepër penale ose jo?! Çështja tjetër ka të bëjë me ndarjen e sipërfaqeve në pjesën nga vij edhe unë, që është "Mati 2" dhe "Mati 3", ose ndoshta në të ardhmen na bëhet një prezantim, a është bërë ndarja sipas planifikimit qysh e ka bërë urbanizmi ose Plani zhvillimor urban, apo është bërë ndryshe, sepse me emrat e rinj të rrugëve po është më e vështirë me e zgjidhur. Çështja tjetër ka të bëjë me shtypjen e fletëvotimeve dhe të gjitha çështjeve të tjera, ndoshta do të ishte mirë me qenë një përfaqësues i tyre në këtë komision. Një çështje ndoshta edhe në formë të pyetjes, ka të bëjë me nenin 4, paragrafin 3, nuk po e kuptoj se si është menduar, ku thotë se së paku tre anëtarë të komisionit të Komunës duhet të jenë të pranishëm në të gjitha tubimet zgjedhore. D.m.th. kjo është përjashtuar ose përveçse kuorumit të komisionit, në secilën tre prej tyre duhet me qenë domosdo. Si është forma që përcaktohen kush janë ata tre edhe në një rast mund të ketë kuorum, ose mund të mungojë vetëm njëri prej tyre dhe mund ta konsiderojmë të dështuar atë tubim zgjedhor. Këto janë çështjet që mendoj se duhet të trajtohen gjatë diskutimit publik.

**Shefki Gashi** theksoi se te neni 12, thuhet se financimi i aktivistëve të këshillave lokalë mund të bëhet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit, apo lagjes urbane. Unë nuk e di sa para duhet me i kërkuar ai, ku i merr, qysh i merr ato para prej banorëve, kur ai është organ i zgjedhur prej organeve të Komunës dhe ata qytetarë e paguajnë tatimin dhe obligimet tjera.

**Kryesuesi**, meqenëse kjo shkon në diskutim publik, është mirë që jepen vërejtje, të cilat e begatojnë këtë rregullore.

**Naime Osmani** theksoi se përveç te përfaqësimi i kuotës gjinore, te pika 7, ku thuhet "Kandidatët për pozita të anëtarëve dhe të kryetarëve të këshillave lokalë, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur në poste publike". Unë nuk pajtohem me këtë, por po sugjeroj që këtu të përfshihen edhe kandidatët që janë në poste publike, sepse ne anëtarët e Kuvendit të Komunës njihemi si persona përfaqësues politikë.

**Kryesuesi** tha se në fund të pasusit të nenit 4 të vendimit, duhet t'i shtohet edhe "zyrtari përgjegjës për informim i Komunës".

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 39 vota për, u miratua Propozimvendimi për lënien në diskutim publik të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, dërgohet për diskutim publik.**

## **Pika e tretë**

### **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të përgjithshëm për vitin 2015.**

**Shemsi Veseli**, në emër të Grupit parlamentar, në mungesë të kryetarit dhe të nënkryetarit të Komunës, kërkoi që ose të shtyhet kjo pikë, ose le të vijnë kryetari dhe nënkryetari, se nuk ka të drejtë kurrkush dhe nuk ka autorizim për me i dhënë sqarimet e duhura lidhur me raportin.

**Kryesuesi** tha se tash unë u njoftova se kryetari e ka autorizuar përfaqësuesin, z. Bllaca për të raportuar lidhur me Raportin e auditimit të përgjithshëm.

**Agim Gashi** u shpreh i pajtimit me propozimin e z. Veseli, që të vazhdohet me pikat tjera të rendit të ditës, në qoftë se në ndërkohë vjen kryetari ose nënkryetari, atëherë mund t'i rikthehem kësaj pike, përndryshe kjo pikë duhet të shtyhet.

**Feti Mehdiu** theksoi se kjo pikë e rendit të ditës mundet të shqyrtohet edhe kështu siç është, me një plotësim. Është mirë që u propozua që kryetari të jetë këtu, por ne mendojmë që në mungesë të kryetarit, arsyetimet mund t'i japë edhe i autorizuari i kryetarit.

**Sokol Krasniqi** tha se z. Bllaca nuk mund në këtë rast të japë mendime dhe përgjegjësi lidhur me auditimin e bërë nga Auditori i përgjithshëm, sepse edhe vetë ai dhe zyra e tij është çështje e të audituarit.

**Lirak Çelaj** shprehu mendimin që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 ( njëzet e katër) vota për me u shty kjo pikë ( Agim Gashi, Besa Rafuna, Blerand Stavileci, Egzona Podvorica, Feti Mehdiu, Fisnik Osmani, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Hazir Borovci, Hetem Kupina, Kimet Zeqa, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Sokol Krasniqi, Vlora Dumoshi), 13 ( trembëdhjetë ) vota për me u vazhduar kjo pikë, dhe 5 ( pesë ) abstënime, shqyrtimi i Raportit të auditimit të përgjithshëm për vitin 2015, shtyhet për diskutim për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.**

## **Pika e katërt**

### **Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut rajonal natyror "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur.**

**Genc Bashota** tha se parku rajonal "Gërmia" është shndërruar në peizazh të mbrojtur në bazë të ligjit në fuqi, për arsye se si park rajonal nuk definohet me ligj. Para disa muajve Ministria e ka kthyer vendimin e asamblesë si të jashtëligjshëm, për shkak të disa vonesave dhe për shkak të mungesës së hartës, d.m.th. lokacioni nuk ka qenë mirë i definuar.

Ato vërejtje më vonë i kemi korrigjuar, duke e ruajtur esencën e vendimit paraparak.

**Fisnik Osmani**, në emër të GP të LDK-së, propozoi që kjo pikë të shtyhet.

**Qëndron Kastrati** bëri të ditur se për parcelat të cilat janë private në zonën e paraparë që tash të mos jetë në pjesën e Gërmisë, kemi kërkuar nga ekzekutivi një historik jo për të gjithë parcelat, por në formë zik-zake, sepse në të kaluarën edhe në pjesët tjera kemi pa vendime ku ato prona private janë eksproprijuar nga ekzekutivi i atëhershëm. Ekzekutivi nuk e ka plotësuar kërkesën tonë dhe për këtë arsye ne sot nuk do të votojmë.

**Lirak Çelaj** tha se në parim e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe njëherësh e përkrahim kërkesën që të dimë më shumë për pronë, por nuk po besoj që jemi institucioni kompetent me e bërë atë vlerësim, ka institucione të tjera që e vlerësojnë këtë punë.

**Mirlinda Sopi** e përkrahu miratimin e kësaj pike.

**Rita Begolli**, në emër të grupit e përkrahu miratimin e kësaj pike.

**Feti Mehdiu** u shpreh se përderisa të plotësohet me ato vizatime, skicat që u kërkuan, të cilat momentalisht nuk e dimë si qëndrojnë, nuk do ta përkrahim. Kur të plotësohet, le ta sjellin për diskutim.

**Abetare Fazliu** u shpreh në përkrahje të miratimit, me të gjitha ndryshimet që u cekën.

**Nora Kelmendi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit**, tha se së shpejti do ta sjellim historikun e parcelave, mirëpo duhet ta sqaroni për cilat parcela. Nëse kemi të bëjmë me shumë parcela, nuk mund të kryhet për një javë. Për historik na nevojitet një kohë më e gjatë.

**Shefki Gashi**, bëri vërejtje në materialet e kësaj pike, duke thënë se këto materiale – harta, janë të paqarta dhe nuk mund të vërehen si duhet, prandaj kërkoj që të ecim pak me kohën, që sipërfaqet të jenë më të fokusuara.

**Kryesuesi konstatoi se më 28 (njëzet e tetë) vota për, 12 (dymbëdhjetë) vota kundër (Bardha Dida - Rogova, Berat Lahu, Feti Mehdiu, Genc Sherifi, Hatixhe Hoxha, Hatixhe Latifi Pupovci, Kimet Zeqa, Qëndron Kastrati, Sadri Ramabaja, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi, Ylli Hoxha), u miratua Vendimi për rikategorizimin e parkut rajonal natyror "Gërmia" në kategorinë - peizazh i mbrojtur.**



#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për themelimin e grupit punues të Kuvendit të Komunës për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2017.**

Lirak Çelaj propozoi që në vend të **Laura Zherkës**, anëtare e komisionit të jetë **Lirie Avdiu**.

Me propozimin e dhënë, Kryesuesi konstatoi se më 39 (tridhjetë e nëntë) vota për, 1 (një) abstenim, (Feti Mehdiu), u miratua Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për komunitete.**

Lirak Çelaj për anëtar të komitetit e propozoi z. Shemsi Veseli.

Me propozimin e dhënë, Kryesuesi konstatoi se më 35 (tridhjetë e pesë) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Berat Lahu, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi), 1 (një) abstenim, (Shemsi Veseli), u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për komunitete, që z. Shemsi Veseli të jetë anëtar i këtij komiteti.

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.**

**Ardian Olluri** tha se ndryshimet që janë propozua në rregullore, janë të nevojshme për miratimin e planit të vendosjes së qoshqeve, që është diskutuar në mbledhjen e kaluar. Këto ndryshime janë të nevojshme të bëhen në rregullore, në mënyrë që ai plan të jetë në pajtim me rregulloren, ku ka qenë edhe një konsensus në Kuvend dhe është arritur pajtueshmëri që të bëhen këto ndryshime në rregullore.

**Agim Gashi** kërkoi nga përfaqësuesi i Zyrës ligjore, ta interpretojë nenin 16 të rregullores, i cili është dashtë të ndryshohet, sepse me ndryshimin e emrave të drejtorive, tash më nuk kemi Drejtori të Urbanizmit, qysh ka qenë më herët, është themeluar drejtoria e re. Çështja tjetër është se në bazë të rregullores përkatëse, komisioni që bën pranimin e punëve, d.m.th. nuk vjen nga Drejtoria e Urbanizmit, por mbikëqyret dhe bëhet pranimi nga Drejtoria e Inspektoratit dhe në qoftë se ky ndryshim bëhet në nenin 16, këtu bien nenet 17 dhe 18. Kërkoj sqarim nga përfaqësuesi i Zyrës ligjore, i cili në mënyrë më kompetente do të na ndihmojë në kompletimin e ndryshimeve në tërësi.

**Qëndron Kastrati** tha se ne si GP, jemi për këto ndryshime që të përshtatet në raport me planin e ri të vendosjes së qoshqeve, në aspektin e përmbajtjes të ndryshimeve të kësaj

rregulloreje. Për këtë mbledhje nuk jemi gati, në të ardhmen mund ta sjellim prapë në Kuvend, nëse konsiderohet që është e nevojshme.

**Lirak Çelaj** ceku se edhe në parim e përkrahim, me vërejtjet që u dhanë nga parafolësit. Duhet pasur kujdes që të rregullohet kjo çështje, sepse, e kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar, nuk janë vendosur si duhet qoshqet aktuale dhe në shumë raste e kanë shëmtuar qytetin. Duhet pasur parasysh përzgjedhjen e njerëzve që do të punojnë aty, gjegjësisht do t'i marrin këto në shërbim, t'u jepet përparësi atyre që kanë qenë dikur ish-punëtorë të ndërmarrjes "Rilindja" dhe kjo të jetë një nga kritereve me rastin e përzgjedhjes së atyre që do t'i marrin në shfrytëzim këto qoshqe.

**Mirlinda Sopi** tha se në parim e përkrahim këtë rregullore. Në mbledhjen e kaluar, kur ishte rregullorja për qoshqe, kemi diskutuar për mirëmbajtjen e këtyre hapësirave kur të merren në shfrytëzim. Komuna duhet gjetur mënyrën për t'i inspektuar, ose për t'i menaxhuar kur të jepen në shfrytëzim, në mënyrë që të mos ia prishin estetikën qytetit.

**Brahim Mehmetaj**, në emër të GP-së, në parim e përkrahim këtë rregullore, por gjithmonë duke dashur që të mos ketë vetëm konotacion komercial, por të shikohet edhe aspekti social, që të ndikojë në zbutjen e papunësisë.

**Shefki Gashi** shprehu mendimin se atyre njerëzve që i kanë në shfrytëzim tash për tash ato qoshqet, t'u ofrohet mundësia e vazhimit të kontratave, sepse ata janë të përzgjedhurit që kanë qenë me kushtet më të vështira nga 650 qoshqet sa janë larguar nga Prishtina.

**Ylli Hoxha** tha se me rëndësi është ta votojmë zgjerimin prej 15 në 18 m<sup>2</sup> për qoshqe, sepse ky është motivi i sjelljes së saj, por edhe ato ndryshime të cilat e bëjnë rregulloren të përshtatshme, pra të ligjshme, është mirë t'i bëjmë këto menjëherë, d.m.th. tash në formë të amendamenteve, dhe i votojmë.

**Me ndryshimet dhe plotësimet e propozuara, Kryesuesi konstatoi se më 36 (tridhjetë e gjashtë) vota për, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.**

#### **Pika e tetë**

**Informatë për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit parauniversitar, gjatë vitit shkollor 2015/2016.**

**Arbërie Nagavci**, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, prezantoi suksesin dhe rezultatin e nxënësve në të tri nivelet e arsimit parauniversitar. Lidhur me këtë ceku se analiza e rezultatit bëhet në çdo fillim të vitit.

Në materialet që ua kemi dërguar, i keni të dhënat e detajuara për secilën shkollë, për secilin nivel të shkollimit, si për suksesin e arritur, krahasimin në mes të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, mungesat e nxënësve, mungesat e mësimdhënësve dhe të dhënat rreth vijueshmërisë së procesit mësimor gjatë vitit shkollor.

**Agim Gashi** tha se më vjen mirë që është përfshirë edhe pjesa e informatës ku përfshihen edhe institucionet private, si pjesë integrale e sistemit të arsimit në nivel të komunës.

Sa i përket përmbajtjes së kësaj informate, e cila përfshin tri nivelet e arsimit publik dhe privat, është një pasqyrim real i të dhënave që vijnë nga institucionet edukativo – arsimore të këtyre niveleve, të zbërthyera sipas normave analitike të prezantimit të informatave që trajtojnë përmbajtje të tilla.

**Hatixhe Hoxha**, shprehu mendimin se kjo informatë përmban ecurinë e arsimit dhe performancën për vitin shkollor 2015/2016, suksesin, rezultatet e arritura dhe krahasimin me vitin e kaluar. E vlerësojmë vizitën që e ka bërë drejtoresha e Arsimit nëpër shkolla dhe institucione shkollore, me karakter mbështetës dhe këshillues, në kontakt me drejtorët dhe stafin mësimor. Njëherësh janë vizituar edhe shkollat-pilot, si: shkolla “Faik Konica”, shkolla “Model” dhe shkolla “Afrim Gashi”. Duhet të nxirren edhe përparësitë dhe të gjitha ato të mirat që i jep ky model i shkollës. Duhet të krijohen shërbimet profesionale për vlerësimin e performancës edhe të mësimdhënësve, duke pasur parasysh faktin se kemi dalë me rezultate tepër të ulëta në vlerësimin ndërkombëtar të organizuar nga PISA, e që janë shumë shqetësuese.

**Lirie Avdiu**, shprehu interesim të dijë se sa shkolla dhe cilat shkolla janë pajisur me laboratore, biblioteka, rekuizita të tjera sportive dhe a e ka në plan Drejtoria që të vazhdojë edhe me shkolla të tjera, duke pasur parasysh që nevojat e tilla për shkolla janë të shumta. Më intereson edhe çështja e mungesave të nxënësve të nivelit të mesëm të lartë, që është një numër shumë shqetësues i mungesave të paarsyeshme. A ka Drejtoria ndonjë plan për uljen e kësaj shifre, sepse dihet që këto mungesa zakonisht bëhen për shkak të ikjes së nxënësve nga orët, dhe a ka ndonjë ide apo plan për parandalimin e ikjes së nxënësve nga orët e mësimi?

**Mirlinda Sopi** theksoi se vitin e kaluar kemi ngritur shqetësimin për mungesat e paarsyeshme që kanë qenë, dhe tashmë pash që në nivelin e ulët dhe të mesëm është numër më i vogël krahasuar me vitin e kaluar. Të njëjtin shqetësim e kam edhe për shkollat e mesme, ku duhet të ketë një strategji të parandalimit, se ata nxënës për një arsye e lëshojnë orën ose mungojnë. Drejtoria duhet të mendojë për trajnimet, por edhe takime më të shpeshta me mësimdhënësit, duhet të krijojë një mekanizëm për testimin dhe për kontaktet më të shpeshta me mësimdhënësit, se edhe ata duhet të testohen e jo vetëm nxënësit.

**Rita Begolli** u shpreh se e kemi shqyrtuar raportin për suksesin e nxënësve në tri nivelet në shkollat fillore dhe të mesme. Janë shqetësuese mungesat e shumta. Atë që duam ta dimë, është çështja e psikologëve nëpër shkolla, në të gjitha nivelet e shkollave. A kanë kontrata me normë të plotë, a kërkon shkolla ndonjë raport prej tyre, apo Drejtoria, për punën e tyre dhe deri në sa raste i trajtojnë ata në javë apo në muaj?

Këto pyetje rrjedhin si pasojë e problemeve që vazhdimisht ndodhin nëpër shkolla. Puna e psikologut do të kishte pasur një rol shumë të rëndësishëm në parandalimin e këtyre problemeve.

Edhe një gjë që nuk e pash të përfshirë në raport e duhet të ishte, është digjitalizimi i ditarëve.

**Ylli Hoxha** ngriti shqetësimin e tij, duke cekur se ky raport është punuar mirë, mirë i prezantuar dhe në pamje duket që ne i kemi punët shumë mirë, por në realitet gjendja është alarmante për sa i përket arsimit në Kosovë, e gjithashtu edhe në komunën tonë. Pas përfundimit të testit të PISA-s, është shansi ideale të nisët një proces i reformës në arsim, sepse i duhet një shoqërie një goditje e rëndë, për t'u vetëdijesuar dhe për ta pranuar reformën si mundësi.

**Hatixhe Latifi - Pupovci** ngriti shqetësim lidhur me rezultatin e PISA-s, duke thënë se kjo na ka shqetësuar të gjithëve. Si sugjerim për drejtoreshën do të ishte, që të merren rezultatet e PISA-s dhe të analizohen për komunën e Prishtinës, në mënyrë që të shihet se ku dhe cila shkollë, saktësisht të ceken rezultatet.

**Sadri Ramabaja** shprehu mendimin se ajo që do të duhej të ishte objekt jo vetëm i këtij Kuvendi, por në fakt i arsimtarëve të Prishtinës dhe gjithandej Kosovës, se pa një vetëdijesim politik rrënjësor për një ndryshim rrënjësor, nuk mund të përmirësohet gjendja me reforma.

**Sylejman Pireva** theksoi se duhet të përdoret një metodë e njëjtë, siç po ndodh në Shqipëri, të fillojë testimi i vetë mësimdhënësve, janë vërtet profesionalisht të përgatitur për mësimdhënie apo nuk janë. Këtë gjë nuk e kemi ne, andaj është mirë që kjo të praktikohet edhe te ne.

**Merita Surkishi** ceku shqetësimin që ka të bëjë me faktin e imponimit të nxënësve për mbajtje të kurseve private, siç janë ato në matematikë, biologji e lëndë të tjera. Do të duhej që ju si drejtori të paraqitni ndonjë alternativë, çoftë përmes orëve shtesë brenda në shkollë, për ata nxënës që shihet se është e nevojshme, ose përmes ndonjë trajnim, sepse janë të njëjtit profesorë ose arsimtarë që japin atë lëndë në shkollë publike dhe të njëjtit kërkojnë nga prindërit që fëmijët e tyre t'i dërgojnë dhe të paguhen çdo muaj me pagë shtesë.

**Shefki Gashi** tha se të gjithë drejtorët e shkollave duhet të kërkojnë falje që kanë dështuar, edhe nja 20-30% e mësuesve të bëjnë një zgjidhje për kualitetin e dobët të mësimdhënies. Ndaj nxënësve të padisiplinuar duhet të merren masa, të punojnë me ta psikologë dhe pedagogë.

**Qëndron Kastrati**, falënderoi drejtoreshën që ka bërë punë jashtëzakonisht të madhe. Krahasuar me komunat tjera, në komunën e Prishtinës ka ndryshime të mëdha në lëmin e arsimit, por këto nuk janë të kënaqshme dhe të mjaftueshme. Lidhur me këtë, ai shprehu mendimin se aq sa ka faj drejtoresha, ka faj edhe kryetari i Komunës, kemi faj edhe ne si Kuvend i Komunës. Pra, nuk e konsideroj më që kjo është çështje e procedurave, konsideroj që duhet të ketë veprime më radikale për ta ndryshuar në të mirë cilësinë në arsim.

**Sofije Bunjaku** theksoi se problemi kryesor nuk është tek mësimdhënia, siç po mendojnë shumica, por problemi kryesor është tek universiteti, që po pranohen studentë të ndryshëm dhe po ju jepet rasti të vinë e ta marrin ditarin në dorë, duke ndikuar kështu edhe në cilësinë e dobët në arsim.

**Teuta Krasniqi** ngriti shqetësim lidhur me mungesat e nxënësve, për çka tha se fajin kryesor e kanë profesorët ose arsimtarët, por edhe prindërit, të cilët nuk tregojnë interesimin e duhur për fëmijët e tyre. Për numrin e madh të mungesave nxënësit ose shumë rrallë, ose fare nuk përjashtohen nga shkolla. Kjo ndoshta është si pasojë e mungesës së rregullores së arsimit ose shkollës.

**Hetem Kupina** kërkoi të dijë se çfarë plani të veprimit, ose çfarë strategjie ka përgatitur Drejtoria e Arsimit dhe çka ka paraparë në raportin e saj që gjendja e sigurisë në shkolla të jetë më e mirë.

**Naime Osmani**, ngriti shqetësimin lidhur me nxënësit e klasave të ulëta prej klasës I-V, duke thënë se ata janë të moshës së mitur, dhe me i ngarkuar me mësim tërëditor, për ta është një ngarkesë e madhe.

Ajo shprehu mendimin se në asnjë shkollë nuk ka kushte për zhvillimin e mësimin tërëditor.

**Bardha Dida - Rogova** tha se ndoshta më mirë është të bëjmë një plan të trajnimit të mësimdhënësve, sepse një profesionist në qoftë se nuk trajnohet vazhdimisht, brenda katër viteve mund të ketë ndryshime aq të mëdha, sa që ai nuk mund të jetë në hap me kohën. Ajo shprehu mendimin se plani i trajnimit është më i rëndësishëm sesa testimi i mësimdhënësve.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, **Arbërie Nagavci** dha sqarime të nevojshme.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata për suksesin dhe rezultatin e nxënësve, i arritur në tri nivelet e arsimit para universitar gjatë vitit shkollor 2015/2016.**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19, B 20, të lagjes “Mati 1” (“Kodrina”).**

**Shefki Gashi** tha se këtë projekt e kam përkrahur, por kërkoj nga Zyra ligjore që ta bëjë qartë definimin mes pronës shoqërore dhe pronën komunale.

Po ashtu, ai kërkoj që t’i bëhet me dije investitorit që t’i ketë parasysh edhe ata qytetarë përreth aty, që kanë nga 5, 10 apo 20 arë tokë, që mos të mbesin jashtë projektit.

**Qëndron Kastrati** theksoi se nëse në atë zonë ka pronë publike, në të ardhmen patjetër duhet të kalojë përmes Kuvendit të Komunës, nëse donë me u përfshirë ose jo. Ne sot jemi duke vendosur veç për planifikim, që nuk lidhet me pronësinë private apo publike.

Ne si grup do ta përkrahim për miratim.

**Lirak Çelaj** bëri të ditur se, si GP në parim janë për planifikime të tilla, por atëherë kur do të ishte do ta merrte iniciativën Komuna. E kemi thënë dhe qëndrojmë prapa asaj, se janë shkelur procedurat, dhe për këtë duhet të ndiqen procedura penale nga institucionet relevante. Ne nuk jemi për t’i ndaluar planifikimet e tilla, përkundrazi, i inkurajojmë që edhe pjesë të tjera të qytetit të bëhen bashkë dhe të ndërtojnë.

**Mirlinda Sopi** përkrahu procedimin e kësaj pike, për faktin që të mos u ndalohet qytetarëve një projekt i tillë, meqë janë pajtuar pronarët e tokave dhe investitori. E përkrahim që të kalojë në diskutim publik, pastaj kur të kthehet në Kuvend prapë do ta diskutojmë.

**Imer Rusinovci**, në emër të GP-së, e përkrahu procedimin e mëtejshëm, por shprehu brengë për faktin se prona është element i shenjtë dhe në kuptimin e hapit të parë në planifikim, kërkojmë që në kuptimin legjislativ të saktësohet qartë çështja e pronës.

**Shemsi Veseli**, u shpreh se, së pari, na mungon dokumentacioni relevant që duhet ta kemi sot. Është nënshkruar një memorandum, më 25 qershor 2015, dhe nuk na është prezantuar. Cila është arsyeja që ne nuk e kemi atë dokument në Kuvendin e Komunës?! Pasi që është anashkaluar Kuvendi, jam kundër këtij propozimvendimi dhe nuk do ta votoj.

**Ardian Olluri** dha sqarime lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit.

**Kryesuesi konstatoi se më 16 ( gjashtëmbëdhjetë) vota për, 4 (katër) vota kundër, (Egzona Podvorica, Halim Halimi, Laura Zherka, Shemsi Veseli ) dhe 10 abstenime (Besa Rafuna, Brahim Mehmetaj, Fadil Gashi, Imer Rusinovci, Lirie Avdiu, Merita Surkishi,**

**Naime Osmani, Rita Begolli, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi), u miratua vendimi për lënien në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për blloqet B 17, B 18, B 19, B 20 të lagjes "Mati 1" ( "Kodrina").**

**Pika e dhjetë**

**Caktimi i një anëtari të Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Hortikultura" SHA dhe NPK "Trafiku Urban" SHA Prishtinë.**

**Lirak Çelaj, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.**

**Brahim Mehmetaj kërkoi sqarim nga kryesuesi lidhur me shtyrjen e kësaj pike.**

**Kryesuesi konstatoi se më 14 (katërmbëdhjetë) vota për, 11 ( njëmbëdhjetë ) vota kundër, ( Bardha Dida - Rogova, Berat Lahu, Brahim Mehmetaj, Fadil Gashi, Genc Sherifi, Hatixhe Latifi - Pupovci, Imer Rusinovci, Rita Begolli, Sadri Ramabaja, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi) dhe 5 (pesë) abstënime ( Mirlinda Sopi, Remzi Pacolli, Sofije Bunjaku Ylli Hoxha), Caktimi i një anëtari në Komisionin komunal të aksionarëve në NPL "Hortikultura" SHA dhe NPK "Trafiku Urban" SHA Prishtinë, shtyhet për mbledhjen e radhës.**

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Pyetje dhe përgjigje.**

**Lirak Çelaj, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës dhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.**

**Në mbledhjen e kaluar i kam shtruar disa çështje, por për njëren prej tyre kam marrë përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Kulturës. Në ndarjen e këtyre qoshqeve besoj se ka hapësirë edhe për hetim, sepse po konsideroj që ka pasur manipulime në këtë punë. Kjo çështje më duket pak absurde. Pse kjo të jetë në kuadër të Drejtorisë së Kulturës, e jo të Drejtorisë së Shërbimeve Publike?!**

**Hetem Kupina:**

**Për kryetarin e Komunës, z. Shpend Ahmeti.**

**Kërkoi nga kryetari që urgjentisht ta thërret mbledhjen e Këshillit për siguri në bashkësi, të cilën nuk e ka mbajtur që 18 muaj. Pra, kërkohet nga kryetari i Komunës që t'i urdhërojë ekspertët që sa më shpejtë ta përgatisin një plan strategjik dhe një plan veprimi, për ta luftuar të keqen e cila e cenon sigurinë në komunën e Prishtinës.**

**Për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit.**

**Në ç' masë është duke u respektuar ligji për duhanin? Përgjigjja të më kthehet me shkrim.**

**Për drejtorin e Drejtorisë së Pronës.**

E lus drejtorin që urgjentisht ta formojë një komision për identifikimin e pronës së uzurpuar komunale dhe lirim të saj.

**Ylli Hoxha, për drejtorin e Drejtorisë së Financave.**

Pyetja ka të bëjë me çështjen e tatimit në pronë, ku ekziston një problem i cili ka të bëjë me qytetarin. Ekziston një numër i konsiderueshëm i qytetarëve që janë me emër dhe mbiemër të njëjtë. Ka raste të shumta kur një tatimpaguesi i ngarkohet edhe një pronë e cila nuk është e tij dhe ky tatimpagues për shkak të kushtëzimit që ia kemi bërë për shërbime komunale, detyrohet që çdo herë të nisë një procedurë në drejtorinë përkatëse që të verifikohet nëse ajo pronë është e tij apo jo. Duhet të merren masa lidhur me këtë çështje. Nëse ka ndonjë përgjigje e cila e arsyeton situatën, le të na jepet, nëse jo, atëherë le të merren masa adekuate që urgjentisht të rregullohet kjo çështje.

**Hatixhe Latifi - Pupovci, sugjerim për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.**

Besoj që ka ndonjë mekanizëm që mund të merret me sanimin e gropave në komunën e Prishtinës. Do të ishte mirë që Komuna, përmes një kompanie, të sigurojë kubeza, me të cilat përkohësisht do të mbylleshin gropat në Prishtinë, e mos të lihen derisa të kalojnë tenderët, sepse po ka pengesa që shkaktojnë shqetësime për qytetarët.

**Shemsi Veseli, pyetje për drejtorinë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike.**

Aty ku jam duke banuar, janë banesat me koncesion. Pyes se çka është duke u punuar aty, se nuk e kam të qartë dhe, në anën tjetër, a është bërë ai ndryshim dhe kush e ka bërë atë ndryshim, sepse aty është parapa të jetë gjelbërim?

**Pika e dymbëdhjetë**

**Të ndryshme.**

**Ferat Makolli, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, sugjerim për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit:**

Dua ta ngre një shqetësim lidhur me ndotjen e ambientit në komunën e Prishtinës, e posaçërisht te liqeni i Badovcit, ku njerëz të papërgjegjshëm po i hedhin gomat dhe natën po shkojnë e po i djegin. Po të shkojmë të shikojmë, është një deponi e qindra ose mijëra gomave, të cilave natën u vihet flaka dhe krejt ai tym shkon drejtpërdrejtë në liqenin e Badovcit. I bëj apel Inspektionit që të ndërmerren masa në këtë drejtim.

Mbledhja mbaroi në orën 16:00.

**Procesmbajtësja**  
**Luljeta Selimi**